

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Rekursi i Veliajt në Gjykatën e Lartë/ GJL lë fuqi vendimin e GJKKO-së, Erion Veliaj mbetet në burg
ADRESA	https://dosja.al/live-updates/kushtetuesja-tha-se-arresti-i-tij-ishte-jo-proporcional-gjykata-e-l-i514217
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	edited

KOHË


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 09:26:35 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 09:10:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	b5cfdcd7491cf76d85eef340a07999d5608c5b484b8030231aa4beafafb82ead
TEKSTI	4a4cb884bb0f258543f63d14391312459b6bd31a4ace610f3823dc9014419275
PAMJA	7ec5f416f8a6af53d8db6c9d11f1d15997fda58512761731656bfe0882212a2a

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	69cb7e12cd99e16d38d03ffbf5f727da06ecf4665098e9b5146762d008137524
E MËPARSHMJA	2f22370d347b986005a9f2cd693fcac17da122a8c86e73a35a1a8ef1a6b76762
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/69cb7e12cd99e16d38d03ffbf5f727da06ecf4665098e9b5146762d008137524>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES

1 ORE ME PARE

Rekursi i Veliajt në Gjykatën e Lartë/ GJL lë fuqi vendimin e GJKKO-së, Erion Veliaj mbetet në burg

17 ORE ME PARE

107 ditë revoltë, qytetarët nuk e ndalin rezistencën, oshëtin bulevardi: Shqipëria kërkon revolucion

17 ORE ME PARE

Më 16 shtator jepet vendimi për Thačin dhe ish-krerët e UÇK-së/ Kurti: Uroj të kthehen të lirë. Ambasada e SHBA në Prishtinë: Priten protesta, kini kujdes

22 ORE ME PARE

"Në epigjendër të takimeve ishte narkoshteti"/ Berisha pas kthimit në SHBA: Trump denoncoi rrezikun komunist dhe rrezikun e drogës, mbi të cilat qëndron regjimi i Ramës!

LIVE UPDATES

Rekursi i Veliajt në Gjykatën e Lartë/ GJL lë fuqi vendimin e GJKKO-së, Erion Veliaj mbetet në burg

• Gjykata e Lartë shqyrtoj ditën e sotme masën e sigurisë ndaj kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj. • Seanca u zhvillua në orën 09:30 në Dhomë Këshillimi, nga gjyqtarët Sandër Simoni, Valbon Cekrezi dhe Gent Shala. • Në qendër të shqyrtimit ishte masa "arrest me burg" e caktuar ndaj Veliajt, ku Gjykata e Lartë do duhet të arsyetonte nëse ishte proporcionale masa e sigurisë "arrest me burg" në raport me pozicionin që Veliaj ka si kryebashkiak. • Në fund të seancës, Gjykata e Lartë rrëzoi kërkesën e Veliajt për ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Posaçme të Apelit, duke lënë në fuqi masën e sigurisë ndaj tij. • Veliaj kërkonte shfuqizimin e vendimeve të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë, Gjykatës së Posaçme të Apelit dhe një vendimi të mëparshëm të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, lidhur me masën e sigurisë ndaj tij. • Çështja u rikthye për shqyrtim pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, e cila kishte kërkuar rishikimin e proporcionalitetit të masës së sigurisë. • Ajo argumentonte se Gjykata e Lartë nuk kishte dhënë argumente të mjaftueshme se pse Veliaj ai duhet të mbahet në burg, ndërkohë që është Kryetar i Bashkisë së Tiranës.

6 artikuj për këtë temë.

35 MINUTA ME PARE

Erion Veliaj u la në burg/ Avokati Ndreca: Gjykata e Lartë la në fuqi një vendimmarrje të shfuqizuar nga Kushtetuesja, po mbajnë peng ushtrimin e mandatit të tij



Erion Veliaj dhe Plarent Ndreca

TIRANA- Avokati Eron Veliajt, Plarent Ndreca ka reaguar pas vendimt të Gjykatës së Lartë, e cila la na në burg kryebashkiakun. Përmes një postimi në rrjetet sociale, ai u shpreh se Gjykata e Lartë la në fuqi një vendimmarrje të shfuqizuar nga Kushtetuesja, duke shtuar se po cenohet shteti i së drejtës.

Më tej, ai tha se rezultati i shpallur sot ngre një pyetje mbi vlerën e garancive kushtetuese në rastet kur vendimet e Gjykatës Kushtetuese nuk zbatohen efektivisht. Avokati paralajmëroi se mbrojtja do të përdorë çdo mjet juridik të parashikuar nga

editoriale

Irena Beqiraj

Fashizmi nuk duhet kërkuar tek revolta e protestuesve por në Kuvend!

Meri Lika

Plaçkaxhiu

Në vëmendje

ART&ARGËTIM 15 SHTATOR 2026, 10:17

Matthew Rhys bën histori në Emmy Awards, bëhet aktori i parë që fiton dy çmime kryesore në një natë

Ndrecë argumentoi se pasojat shkojnë përtej një procesi individual, pasi vendimi i dhënë nga Gjykata e Lartë po pengon ushtrimin e mandatit të kryetarit të zgjedhur të Bashkisë së Tiranës, funksionimin normal të institucionit dhe vullnetin e qytetarëve të shprehur me votë.

Plarent Ndreca: Vendimi i sotëm i Gjykatës së Lartë përbën një zhvillim jashtëzakonisht shqetësues për shtetin e së drejtës, sigurinë juridike, të drejtat themelore dhe mbi të gjitha, për demokracinë në këtë vend. Duke lënë në fuqi një vendim marrje të shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese, ky vendim praktikisht ka lënë pa efekt detyrues vendimin e autoritetit më të lartë kushtetues të vendit.

Sigurisht, do ta analizojmë me përgjegjësi arsyetimin e plotë. Por rezultati i shpallur sot ngre një pyetje dramatike: çfarë vlere kanë garancitë kushtetuese nëse vendimet e Gjykatës Kushtetuese nuk zbatohen efektivisht? Kur një përfundim i tillë nuk gjen shpjegim bindës në Kushtetutë dhe në ligj, atëherë shkaqet duhen kërkuar përtej argumenteve juridike dhe jashtë sallës së gjyqit.

Pasojat shkojnë përtej një procesi individual. Ato mbajnë peng ushtrimin e mandatit të kryetarit të zgjedhur të Bashkisë së Tiranës, funksionimin normal të institucionit dhe vullnetin e qytetarëve të shprehur me votë. Prej 19 muajsh, qytetarët e Tiranës janë privuar nga kryetari që kanë zgjedhur. Z. Erion Veliaj prezumohet i pafajshëm dhe vazhdon të mbahet në paraburgim, ndonëse hetimi ka përfunduar prej një viti dhe çështja ndodhet në gjykim.

E gjithë kjo nuk është arsye për t'u dorëzuar, por për ta vijuar betejën. Mund ta izolojmë dhe t'i kufizojmë mundësinë për të folur, por nuk mund ta mundin politikusit nëpërmjet vendimeve gjyqësore. Një politikan mundet me votë, përballë qytetarëve, dhe jo përmes "laëfare"-it. Ne do të përdorim çdo mjet juridik që parashikon Kushtetuta, ligji dhe instrumentet ndërkombëtare. Shqipëria meriton një drejtësi të standardeve evropiane, e cila garanton të drejtat, respekton vendimet kushtetuese dhe mbron demokracinë, mjetin më të lartë që qytetarët kanë në dorë për të vendosur se kush i përfaqëson dhe kush e drejton vendin./Dosja.al



Plarent Ndreca
rreth një orë më parë



Vendimi i sotëm i Gjykatës së Lartë përbën një zhvillim jashtëzakonisht shqetësues për shtetin e së drejtës, sigurinë juridike, të drejtat themelore dhe mbi të gjitha, për demokracinë në këtë vend. Duke lënë në fuqi një vendim marrje të shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese, ky vendim praktikisht ka lënë pa efekt detyrues vendimin e autoritetit më të lartë kushtetues të vendit.

Sigurisht, do ta analizojmë me përgjegjësi arsyetimin e plotë. Por rezultati i shpallur sot ngre një py... Shiko më shumë

 48

 7

 3

1 ORE ME PARE

Gjykata e Lartë la në burg kryebashkiakun, protestuesit në kor: Rama në burg, Veliaj në burg!



Protesta

TIRANË- Protestuesit që ndodheshin jashtë Gjykatës së Lartë kanë shpërthyer në thirrje kundër kryebashkiakut të Tiranës, Erion Veliaj, pas vendimit të Kolegjit për ta lënë atë në burg.

FOTO/ Zendaya, Selena Gomez dhe yjet e Hollywood-it shkëlqejnë në tapetin blu të Emmy Awards

AKTUALITET 15 SHTATOR 2026, 09:42

Dosja "Revanshi", GJKKO shpall vendimin/ Durim Bami dënohet me 10 vite e 8 muaj burg, ja sa u dënuan anëtarët e tjerë

më të klikuarat

- 

Pse bën foto? Rama kap të riun nga qafa dhe ia dorëzon policisë, çfarë ndodhi në Aeroportin e Napolit? (VIDEO)
- "Mbaje mend do të vras"/ Kërcënohet me vdekje gazetari Osman Stafa, Policia: Materialet u referuan në Prokurori për 3 vepra penale
- Vrasja e Franc Konomit, flasin familjarët e tij/ Gruaja: Hotelin ia mori vëllai dhe ia shiti. I biri: Kanë dashur të më vrasin edhe mua dy herë
- Ilir Meta del nga kafazi/ Apeli i GJKKO pranon kërkesën: Gjatë seancave do qëndrojnë krah avokatit

insights

- Ola Xama**

Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen
- Idriz Konjari**

Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?
- Bledian Koka**

Pse Erion Veliaj e "shkarkoi" sot Edi Ramen?
- Fjola Graçi**

REPUBLIKA E TRUPROJAVE/ Nga tokat te klubet VIP: Rrjoll, Zvërnec, Sarandë e Ksamil nën hijen e "burrave të zini"

“Kama në burg, Veliq në burg”, janë disa prej thirrjeve të protestuesve, të cilat janë bërë me megaton pas shpalljes së vendimit.

Gjykata e Lartë vendosi të lërë në fuqi masën e sigurisë “arrest në burg” për Veliqin, i cili kishte bërë rekurs kundër vendimit për qëndrimin e tij në qeli.

Moti

Powered by  tomorrow

2 ORE ME PARE

Veliq mbetet në burg, Gjykata e Lartë rrëzon rekursin e kryebashkiakut



Erion Veliq

TIRANË- Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur të lërë në fuqi masën e sigurisë ‘arrest me burg’ për Erion Veliqin. Gjatë mbledhjes së sotme, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë shqyrtoi kërkesën e Erion Veliqit kundër vendimeve të mëparshme të gjykatave të posaçme.

Veliq kërkonte shfuqizimin e vendimeve të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë, Gjykatës së Posaçme të Apelit dhe një vendimi të mëparshëm të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, lidhur me masën e sigurisë ndaj tij. Pas shqyrtimit të çështjes, Kolegji Penal vendosi lënen në fuqi të vendimit ‘arrest me burg’ për Veliqin.

Njoftimi i Gjykatës së Lartë:

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i mbledhur në datë 15 shtator 2026, në Dhomë Këshillimi, mori në shqyrtim dosjen penale me palë: Kërkuar: Erion Veliq, Palë e Interesuar: Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe objekt: Shfuqizimin e vendimeve nr. 7, dt. 09.02.2025, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin të Organizuar, vlefshuar përmes vendimit nr. 14, dt. 12.02.2025, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin të Organizuar; nr. 13, dt. 13.03.2025, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin të Organizuar; nr. 00-2025-1153 (176), dt. 08.07.2025, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të subjektit të interesuar. Pasi shqyrtoi çështjen, Kolegji, bazuar në nenin 441, pika 1, shkronja “e” të Kodit të Procedurës Penale, vendosi: Lënen në fuqi të Vendimit nr.13 (87-2025-85), datë 13.03.2025 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin të Organizuar.

Për çfarë akuzohet Veliq?

SPAK ka përfunduar hetimet dhe ka dërguar për gjykim në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë dosjen e kryebashkiakut Erion Veliq. Në dosjen e kopsitur nga SPAK 13 akuzat që rëndojnë mbi Veliqin dhe 12 akuzat që rëndojnë mbi bashkëshorten e tij, Ajola Xoxa. Në përfundim të hetimeve paraprake, ka rezultuar se Veliq dhe Xoxa, në bashkëpunim mes tyre, në 9 raste të veçanta, kanë marrë përfitime të parregullta në formën e shumave monetare dhe pasurive të paluajtshme, nga subjekte tregtarë dhe organizata jofitimprurëse, të cilët nga ana e tyre kanë marrë leje ndërtimi dhe përfituar fonde publike nga Bashkia Tiranë.

Nga hetimi penal janë grumbulluar të dhëna konkrete, të cilat provojnë se Veliq, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Tiranë, me nënshkrimin e tij ka miratuar në çdo rast shpërndarjen e këtyre fondeve, të cilat më pas kanë përfunduar tek OJF-të e kontrolluara nga bashkëshortja e tij dhe individë të afërt me të. Gjithashtu, këta të pandehur, për shkak të funksionit që kryen Veliq, kanë përfituar në mënyrë të parregullt edhe pasuri të paluajtshme në vlerë të konsiderueshme nga subjekte tregtarë që kanë marrë fonde publike dhe leje ndërtimi nga Bashkia Tiranë.

Në të gjitha këto episode të pandehurit, në bashkëpunim me njëri tjetrin, kanë konsumuar elementët e veprës penale të parashikuar nga neni 260 i Kodit Penal. Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar si edhe organizatat jofitimprurëse të lartpërmendura, duke dhënë përfitime të parregullta për shkak të detyrës që kryen i pandehuri Erion Veliq, kanë konsumuar elementët e parashikuar nga neni 245 i Kodit Penal./[Dosja.al](#)


2 ORE ME PARE

VIDEO/ ‘Lini Veliajn në qeli’! Protestë kundër Veliajt para Gjykatës së Lartë: Në Tiranë paratë u pastruan përmes ndërtimit, me bekimin e tij



Proteste

TIRANË- Qytetarët kanë protestuar para Gjykatës së Lartë, teksa gjyqtarët ndodhen në dhomën e këshillimit për të vendosur mbi rekursin e kryebashkiakut të Tiranës, Erion Veliaj, kundër masës së sigurisë “arrest në burg”. Protestuesit kanë kërkuar që Veliaj të vijojë të qëndrojë në qeli, ndërsa kanë thirrur: “O gjykatës, bëj drejtësi, lër Veliajn në qeli”.



Një prej protestuesve tha se lirimi i Veliajt do të ishte një goditje e madhe për sistemin e drejtësisë në Shqipëri. Sipas tij, ndërtimet në Tiranë, përgjimet dhe provat e administruara nga organet e drejtësisë janë ndër arsyet pse kryebashkiaku duhet të qëndrojë në burg.

“Për mua dhe për çdo qytetar, vetëm ndërtimet në Tiranë janë një arsye e mjaftueshme që ai të vazhdojë të qëndrojë në burg. Edhe përgjimet dhe provat që kanë dalë në raport me Veliajn janë arsye dhe argumente të mjaftueshme që ai duhet të qëndrojë në qeli. Një dalje e Veliajt sot do të ishte një goditje e madhe për sistemin e drejtësisë në Shqipëri, pasi do të cenonte pavarësinë e tij”, u shpreh protestuesi.

3 ORE ME PARE

Seanca për Erion Veliajn/ Trupa e Gjykatës së Lartë futet në Dhomën e Këshillimit për çështjen e kryebashkiakut



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.